



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 58, datë 29.03.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROSPEKTIT TË EMETUESIT SHOQËRIA “NOA” SH.A., PËR  
OFERTËN PRIVATE TË EMETIMIT TË OBLIGACIONEVE AFATGJATË ME  
NORMË INTERESI FIKSE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 30, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e prospektit të emetuesit shoqëria “NOA” sh.a., për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë me normë interesi fikse për shumën 150,000,000 lekë.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**